



Nr. 306/2026

Datë: 04.09.2026

Duke u bazuar në Nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës; në Nenin 16, pikën 16.3.3 të Statutit të KMDK-së Sh.A të datës 30.05.2025; në Rregullorën Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm, Pagat, Benefitet dhe shtesat në KMDK Sh.A të datës 29.08.2025; Vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. 33/2025 për miratimin e Përshkrimeve të Vendeve të Punës në KMDK Sh.A. i datës 29.08.2025, dhe neni 5, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2024 për Kriteret dhe Procedurat e Punësimit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A., Kryeshefi Ekzekutiv (KE) i KMDK-së nxjerr këtë:

VENDIM

Për plotësim & Ndryshimin e Vendimit Nr.286/2026 të Kryeshefit Ekzekutiv

- I. SHTYHET** afati i aplikimit në konkursin publik “Udhëheqës i Shërbimit të Inxhinierisë” me nr. të referencës ZP/KJ-12-2026 në KMDK për dhjetë (10) ditë shtesë, deri më datë 18.09.2026.
- II.** Obligohet Departamenti për Shërbime Mbështetëse të njoftojë kandidatët e interesuar përmes publikimit të këtij vendimi në ueb faqe dhe platforma të tjera online, në ditën e njëjtë të hyrjes në fuqi të vendimit.
- III.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Mbështetur në Rregulloren Nr. 01/2024 për Kriteret dhe Procedurat e Punësimit në KMDK Sh.A., vazhdohet afati i konkursit publik për pozitën “Udhëheqës i Shërbimit të Inxhinierisë” edhe për dhjetë (10) ditë shtesë me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv (KE). Kjo shtyrje bëhet me qëllim të rritjes së shikueshmërisë (vizibilitetit) përmes publikimit edhe në rrjete sociale, duke garantuar kështu një proces konkurrues dhe transparent për rekrutimin e kandidatëve sa më cilësorë. Duke qenë se ky profil profesional është i domosdoshëm për të siguruar zhvillimin, mirëmbajtjen dhe

efikasitetin e sistemeve teknike e infrastrukture, rekrutimi i kësaj pozite është esencial për planifikimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të inxhinierisë.

Vendimi u dërgohet:

Arkivit të KMDK SH.A

DSHM-së të KMDK SH.A.



Këshilla juridike: Pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtojë ankesë brenda afatit prej tetë (8) ditësh nga data e publikimit të këtij Vendimi pranë Komisionit të Ankesave të KMDK Sh.A.